



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 16 korrik, Trupi Gjykses shqiptoi aktgjykimin në çështjen gjyqësore Pjetër Shala. Ky është aktgjykimi i dytë i DHSK-së që ka të bëjë me krime lufte.

Trupi Gjykses shpalli fajtor z. Shala për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e dënoi me 18 vjet burgim, ku llogaritet koha e kaluar në paraburgim. Për arsye juridike, Trupi Gjykses shpalli të pafajshëm z. Shala për krimin e trajtimit mizor.

Trupi Gjykses theksoi se gjykimi u zhvillua në kontekstin e atmosferës së vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve, e cila pati ndikim të dukshëm tek dëshmitë e dhëna nga disa dëshmitarë para Trupit Gjykses.

Të dyja palët mund ta apelojnë aktgjykimin duke dorëzuar njoftim për apel brenda 30 ditësh mbi bazë të pretendimit për gabim juridik, gabim faktik ose gabim në dhënien e dënimit.

Më 11 korrik, Trupi Gjykses vendosi të ulte numrin e redaktimeve në deklaratat përmbyllëse në këtë çështje gjyqësore dhe udhëzoi Zyrën Administrative në lidhje me këtë. Ky ishte vendimi i 7-të mbi uljen e numrit të redaktimeve në këtë çështje gjyqësore, në kuadër të përpjekjeve të Trupit Gjykses që seancat të jenë sa më transparente.

Më 12 korrik, Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari u vetëdeklaruan të pafajshëm gjatë paraqitjes së mëtejshme të tyre. Seanca publike u mbajt pas konfirmimit prej Gjykatës së Procedurës Paraprake të aktakuzës së ndryshuar. Aktakuza e ndryshuar përfshinte një akuzë shtesë kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, për shkak të së cilës u bë e nevojshme paraqitja e mëtejshme e tyre.

Duke marrë parasysh akuzën e re dhe për shkak se Mbrojtja e Januzit tha se do të dorëzonte një mocion paraprak në lidhje me të, më 12 korrik, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi vendim me të cilin anuloi afatin e mëparshëm për dorëzimin e dosjeve gjyqësore paraprake prej Mbrojtjes më 15 korrik, dhe urdhëroi Mbrojtjen e Januzit që ta dorëzojë kërkesën për zgjatje të afatit brenda 15 korrikut. Gjithashtu, ajo udhëzoi Mbrojtjen e z. Bahtijari dhe të z. Shala që të dorëzojnë përgjigjet e tyre jo më vonë se të premtën, 16 korrik. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake anuloi afatin e caktuar më parë për kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore trupit gjykses dhe informoi palët se data e re do të caktohet më vonë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 16 korrik, Kryetarja Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës Supreme për të marrë vendim mbi kërkesën e z. Haxhi Shala për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës së





Procedurës Paraprake mbi vazhdimin e paraburgimit të tij. Më 17 korrik, Paneli i Gjykatës Supreme urdhëroi ZPS-në t'i përgjigjet kërkesës së z. Shala, nëse dëshiron, jo më vonë se të hënën, 5 gusht 2024, dhe Mbrojtjen që të kundërpërgjigjet më së voni brenda të hënës, 19 gusht. Paneli përbëhet prej gjykatësve Ekaterina Trendafilova, Kristinë van den Vajgart dhe Daniel Fransen.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 17 korrik, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Shalës për të rishikuar vendimin e saj mbi vazhdimin e paraburgimit të z. Shala bazuar në faktin se afati për kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore trupit gjykues nuk është caktuar ende. Mbrojtja argumentoi se duke marrë parasysh vonesën në kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore trupit gjykues, koha që z. Shala do të duhet të kalojë në paraburgim është e paarsyeshme. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se Mbrojtja e Shalës nuk kishte vërtetuar gabim në arsyetimin e vendimit të saj të mëparshëm dhe theksoi se vonesat në lidhje me kalimin dosjes së çështjes gjyqësore trupit gjykues ndodhën për t'iu përshtatur kërkesave të Mbrojtjes.

Më 15 korrik, Trupi Gjykues II urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në lidhje me të dy të akuzuarit, Trupi Gjykues konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku se ata do të pengojnë ecurinë e procesit ose të kryejnë krime të tjera, veçanërisht duke marrë parasysh fazën e procesit, gjatë së cilës janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren emrat e disa dëshmitarëve tejet të ndjeshëm. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues konstatoi se lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efikase të dëshmitarëve që ende nuk kanë dhënë dëshmi.

Në rastin e z. Selimi, Trupi Gjykues rikujtoi konstatimin e tij se duket se z. Selimi ka nxjerrë më parë informacion të privilegjuar për palë të treta të paautorizuara.

Trupi Gjykues në fund tha se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. Për po të njëjtat arsye, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e z. Krasniqi për lirim me kusht gjatë pushimit të gjykatës.

Gjatë kësaj jave, dëshmitari Bislim Zyrapli vazhdoi dhënien e dëshmisë në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar pas pushimit të gjykatës, më 19 gusht, në orën 9:00 paradite.

